



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT**

**NJOFTIM**

**MBI**

**TAKIMIN E KRERËVE TË INSTITUCIONEVE INFORMUESE DHE  
LIGJZBATUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

“Të gjithë së bashku për qytetarët”

Shërbimi Informativ i Shtetit, në datën 25.01.2023 mirëpriti një takim mes krerëve të institucioneve informuese dhe ligjzbatuese në vend, si Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH), Prokuroria e Përgjithshme (PP), Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH), Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH) dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (AMP).

Zëvendës drejtori i SHISH-it, z. Oljan Kanushi, falënderoi pjesëmarrësit për takimin në Selinë Qendrore të Shërbimit Informativ të Shtetit duke theksuar rolin e SHISH si organ informativ dhe misionin e tij parësor për ruajtjen e sigurisë kombëtare.

Diskutimi mes palëve u përqëndrua në çështjet e garantimit të sigurisë kombëtare dhe luftës kundër paligjshmërisë.

Krerët e institucioneve nënvizuan nevojën për forcimin e bashkëpunimit në këto fusha si dhe për të bashkërenduar punën në shërbim të qytetarëve.

**Tiranë, më 27/01/2023**